

VENDIM
Nr.836, datë 21.10.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

- i) Mirëmbajtje e motoskafeve;
- ii) Blerje pajisjesh këmbimi për lokomotiva e vagonë;
- iii) Përmirësim i furnizimit me ujë në zonën e Shkozetit, pranë Gjykatës së Apelit, Durrës, me vlerë 7 milionë lekë;
- iv) Përmirësim i furnizimit me ujë në zonën e Shkozetit, përballë Gjykatës së Apelit Durrës, me vlerë 5.33 milionë lekë;

v) Rehabilitim i tubacionit Ø=700 mm në zonën e Fushëkuqes;

vi) Furnizimi me ujë në zonën e ish-Kënetës, lagjja nr.14;

vii) Furnizimi me ujë në qytetin e Shkozetit, zona te pallatet e Agro-biznesit, Shkozet, Durrës.

Përjashtimisht, lejohet Shërbimi Informativ i Shtetit të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

Blerje dhe instalim të Qendrës së Re të Përgjimeve të Telekomunikimeve.

Përjashtimisht, lejohet Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

Shtypshkrimi i fletë-ankimeve për regjistrimin e përfituesve të ndihmës ekonomike.

Përjashtimisht, lejohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Inspektorati Qendror Teknik, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

i) Blerje reagent dhe qelqurina;

ii) Kryerje shërbim-kalibrimi të pajisjeve të laboratorit në gjendje;

iii) Blerje aparaturash të reja.

Përjashtimisht, lejohet Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

Blerje pajisjesh të infrastrukturës së rrjetit të deklarimit elektronik.

Përjashtimisht, lejohet Ministria e Drejtësisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

Shtypja e Fletores Zyrtare të të tretët.

Përjashtimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, si autoritet kontraktor, të vijojë kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt:

i) Rikonstrukcion i sistemit të ngrohjes të spitalit Pogradec;

- ii) Rikonstrukcion i korpusit të spitalit Pogradec, sipas masterplanit;
 - iii) Rikonstrukcion i ambienteve dhe furnizimi me energji elektrike për instalimin e grafi-skopisë të spitalit Lezhë;
 - iv) Blerje materialesh konsumi laboratorikë për ISHP-në.
- Përfundimisht, lejohen të gjitha subjektet kontraktore të vijnë normalisht procedurat e prokurimit për shërbimin e ruajtjes së institucioneve me rojë private.”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha